

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER - EDUKIM INKLUZIV



TEZA E MASTERIT

**ZBATIMI I POLITIKAVE INKLUZIVE PËR PARANDALIMIN E
BRAKTISJES SË SHKOLLIMIT TË FËMIJËVE TË KOMUNITETIT
ROM ASHKALI DHE EGJIPTIAN DHE EFEKTI I TYRE NË
SHKOLLA**

Mentor/e

Prof. Asst. Dr. Blerta Perolli Shehu

Kandidatja:

Bleona Hajra

21.05.2026

ABSTRAKTI

Përfshirja e fëmijëve të komunitetit RAE në shkollat tona është një fushë kritike e shoqërisë, e cila shpesh ballafaqohet me sfida dhe pengesa. Ky studim ka trajtuar zbatimin e politikave inkluzive për parandalimin e braktisjes së shkollimit nga fëmijët e komunitetit RAE (Rom, Ashkali dhe Egjiptian) dhe ka vlerësuar ndikimin e tyre në shkolla. Në fokus është mënyra se si këto politika përkthehen në veprime konkrete në institucionet arsimore dhe efektiviteti i tyre në përmirësimin e frekuentimit, përfshirjes dhe arritjeve akademike të nxënësve të komunitetit rom, ashkali edhe egjiptian. Qëllimi i këtij studimi ishte të analizonte në mënyrë të detajuar mënyrën se si zbatohen politikat inkluzive për parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe të vlerësonte ndikimin konkret të këtyre politikave në funksionimin e shkollave. Studimi synoi të identifikonte sfidat kryesore dhe mundësitë që janë hasur gjatë procesit të implementimit të këtyre politikave në praktikë, duke marrë në konsideratë faktorë institucionalë, socialë dhe ekonomikë.

Gjithashtu, fokusi i studimit ishte shqyrtimi i efektivitetit të politikave inkluzive në përmirësimin e frekuentimit të rregullt të shkollës, rritjen e përfshirjes aktive të nxënësve në procesin mësimor dhe avancimin e performancës së tyre akademike.

Pyetjet e hulumtimit – në të cilat është bazuar hulumtimi:

1. Si po zbatohen politikat inkluzive në shkolla për parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët e komunitetit RAE?
2. Cili është ndikimi i politikave inkluzive në përmirësimin e frekuentimit, përfshirjes dhe arritjeve akademike të fëmijëve të komunitetit RAE?
3. Cilët janë faktorët mbështetës dhe sfidat kryesore me të cilat përballen shkollat, mësuesit dhe familjet gjatë zbatimit të këtyre politikave?
4. Si ndikon bashkëpunimi ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit në parandalimin e braktisjes së shkollimit të fëmijëve të komunitetit RAE?

Ky hulumtim është realizuar sipas qasjes cilësore, metodat cilësore të hulumtimeve shkencore kanë rëndësi të madhe për të siguruar rezultate të sakta dhe të besueshme. Në kuadër të këtij hulumtimi,

si instrument kryesor për mbledhjen e të dhënave është përdorur intervista gjysmë e strukturuar. Intervista është hartuar në formë të strukturuar me elemente fleksibile, duke përfshirë gjithsej shtatë (7) pyetje për secilin grup të të intervistuarve. Pyetjet janë dizajnuar në mënyrë që të mbulojnë aspektet kryesore të temës së hulumtimit, duke përfshirë faktorët socialë, psikologjikë dhe institucionalë që ndikojnë në braktisjen e shkollës, si dhe perceptimet mbi rolin e shkollës, familjes dhe institucioneve përkatëse. Në këtë hulumtim janë përfshirë pesë (5) grupe të ndryshme të të intervistuarve, me qëllim që të sigurohet një perspektivë më gjithëpërfshirëse dhe më e balancuar mbi fenomenin e studiuar.

Realizimi i këtij hulumtimi është zhvilluar në disa hapa kryesorë. Fillimisht është hartuar instrumenti i hulumtimit, përkatësisht intervista gjysmë e strukturuar, e bazuar në qëllimin e studimit. Më pas është bërë përzgjedhja e pjesëmarrësve, duke përfshirë pesë grupe të ndryshme të të intervistuarve, të cilët kanë përvojë dhe njohuri lidhur me fenomenin e braktisjes së shkollës. Pjesëmarrësit janë kontaktuar dhe janë informuar për qëllimin e hulumtimit, duke u garantuar konfidencialiteti dhe anonimiteti.

Bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura përmes intervistave, rezulton se fenomeni i braktisjes së shkollës është i ndërlidhur me një sërë faktorësh të cilët veprojnë njëkohësisht dhe ndikojnë në vijueshmërinë e nxënësve në sistemin arsimor. Të intervistuarit kanë theksuar se faktorët socialë, si varfëria dhe kushtet e vështira ekonomike, mbeten ndër arsyet kryesore që çojnë në ndërprerjen e shkollimit. Në shumë raste, familjet përballen me sfida ekonomike që i detyrojnë fëmijët të kontribuojnë në të ardhurat familjare, duke e bërë arsimin një prioritet dytësor.

Nga rezultatet e gjetjeve shohim se të gjitha grupet e të intervistuarve pajtohen për rëndësinë që kanë politikatat inkluzive për parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët e komuniteteve rom, ashkali edhe egjiptian. Megjithatë, secili nga këto grupe ka një perceptim ndryshe rreth efektit të tyre varësisht nga roli institucional që kanë. MASHTI dhe DKA fokusohen në mekanizmat institucional, ndërsa drejtorët e shkollave dhe mësimdhënsit theksojnë sfidat që ata kanë në zbatimin e tyre ndërsa prindërit nuk janë të informuar si duhet dhe kanë nevojë për më shumë mbështetje. Prandaj, ka mospërputhje në mes të politikave dhe zbatimit të tyre në praktikë, dhe ka nevojë për më shumë ndërhyrje.

Në përfundim të këtij punimi, bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura përmes intervistave dhe në shqyrtimin e literaturës përkatëse, mund të konstatohet se fenomeni i braktisjes së shkollës paraqet një sfidë komplekse dhe shumëdimensionale për sistemin arsimor në Kosovë. Ky fenomen nuk mund të shpjegohet vetëm përmes një faktori të vetëm, por është rezultat i ndërveprimit të një sërë faktorësh socialë, ekonomikë dhe psikologjikë, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në vijueshmërinë e nxënësve në arsim. Në përgjithësi, ky punim konfirmon se braktisja e shkollës është një fenomen që kërkon trajtim të integruar dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet familjes, shkollës dhe institucioneve përkatëse. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar mund të arrihet reduktimi i këtij fenomeni dhe sigurimi i një arsimi cilësor dhe të barabartë për të gjithë nxënësit.

Për shkak të rëndësisë dhe kompleksitetit të fenomenit të braktisjes së shkollës, rekomandohet që në të ardhmen të realizohen hulumtime më të gjera dhe më të detajuara në këtë fushë. Studimet e ardhshme mund të fokusohen në përfshirjen e një numri më të madh pjesëmarrësish dhe institucionesh, në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë më gjithëpërfshirëse mbi faktorët që ndikojnë në braktisjen e shkollës. Gjithashtu, do të ishte e rëndësishme të realizohen hulumtime krahasuese ndërmjet komunave të ndryshme në Kosovë, për të identifikuar dallimet dhe sfidat specifike që lidhen me përfshirjen në arsim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Një tjetër fushë me interes për studime të ardhshme është analiza më e thelluar e ndikimit të faktorëve psikologjikë, si motivimi, vetëbesimi dhe ndjenja e përkatësisë në shkollë, në vijueshmërinë e nxënësve në arsim. Po ashtu, rekomandohet që hulumtimet e ardhshme të fokusohen në vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe programeve ekzistuese për parandalimin e braktisjes së shkollës, me qëllim identifikimin e praktikave më efektive dhe përmirësimin e zbatimit të tyre në praktikë.

ABSTRACT

The inclusion of RAE children in our schools is a critical area of society, which often faces challenges and obstacles. This study has addressed the implementation of inclusive policies to prevent school dropout by RAE (Roma, Ashkali and Egyptian) children and has assessed their impact on schools. The focus is on how these policies are translated into concrete actions in educational institutions and their effectiveness in improving attendance, inclusion and academic achievements of Roma, Ashkali and Egyptian students. The aim of this study was to analyze in detail how inclusive policies to prevent school dropout by Roma, Ashkali and Egyptian children are implemented, as well as to assess the concrete impact of these policies on the functioning of schools. The study aimed to identify the main challenges and opportunities that have been encountered during the process of implementing these policies in practice, taking into account institutional, social and economic factors.

The study also focused on examining the effectiveness of inclusive policies in improving regular school attendance, increasing students' active involvement in the learning process and advancing their academic performance.

Research questions – on which the research was based:

1. How are inclusive policies being implemented in schools to prevent school dropout among RAE children?
2. What is the impact of inclusive policies on improving attendance, inclusion and academic achievement of RAE children?
3. What are the supporting factors and the main challenges that schools, teachers and families face when implementing these policies?

4. How does collaboration between school, family and community affect the prevention of school dropout among RAE children?

This research was conducted according to the qualitative approach, qualitative scientific research methods are of great importance to ensure accurate and reliable results. In the framework of this research, a semi-structured interview was used as the main instrument for data collection. The interview was designed in a structured form with flexible elements, including a total of seven (7) questions for each group of interviewees. The questions were designed to cover the main aspects of the research topic, including social, psychological and institutional factors that influence school dropout, as well as perceptions of the role of the school, family and relevant institutions. Five (5) different groups of interviewees were included in this research, in order to provide a more comprehensive and balanced perspective on the phenomenon studied.

The realization of this research was developed in several main steps. Initially, the research instrument, namely a semi-structured interview, was designed based on the purpose of the study. Participants were then selected, including five different groups of interviewees who had experience and knowledge regarding the phenomenon of school dropout. Participants were contacted and informed about the purpose of the research, while ensuring confidentiality and anonymity.

Based on the analysis of data collected through interviews, it turns out that the phenomenon of school dropout is linked to a series of factors that act simultaneously and affect the attendance of students in the education system. Interviewees have emphasized that social factors, such as poverty and difficult economic conditions, remain among the main reasons that lead to the interruption of education. In many cases, families face economic challenges that force children to contribute to family income, making education a secondary priority.

From the results of the findings, we see that all groups of interviewees agree on the importance of inclusive policies in preventing school dropout by children from the Roma, Ashkali and Egyptian communities. However, each of these groups has a different perception of their effect depending on the institutional role they have. MESTI and MED focus on institutional mechanisms, while

school principals and teachers highlight the challenges they face in implementing them, while parents are not properly informed and need more support. Therefore, there is a discrepancy between policies and their implementation in practice, and more intervention is needed.

At the end of this paper, based on the analysis of data collected through interviews and the review of relevant literature, it can be concluded that the phenomenon of school dropout represents a complex and multidimensional challenge for the education system in Kosovo. This phenomenon cannot be explained only by a single factor, but is the result of the interaction of a number of social, economic and psychological factors, which directly affect the attendance of students in education. In general, this paper confirms that school dropout is a phenomenon that requires integrated treatment and close cooperation between the family, school and relevant institutions. Only through a comprehensive and coordinated approach can the reduction of this phenomenon and the provision of a quality and equal education for all students be achieved.

Due to the importance and complexity of the phenomenon of school dropout, it is recommended that in the future more extensive and more detailed research be carried out in this field. Future studies could focus on including a larger number of participants and institutions, in order to provide a more comprehensive picture of the factors influencing school dropout. It would also be important to conduct comparative research between different municipalities in Kosovo, to identify the differences and specific challenges related to the inclusion of Roma, Ashkali and Egyptian communities in education. Another area of interest for future studies is a more in-depth analysis of the impact of psychological factors, such as motivation, self-confidence and a sense of belonging in school, on students' attendance in education. It is also recommended that future research focus on assessing the effectiveness of existing policies and programs for the prevention of school dropout, with the aim of identifying the most effective practices and improving their implementation in practice.